


TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT
BULETINI I TRETË MJEDISOR DHE SOCIAL



Tirana International Airport
Nënë Tereza

Përmbajtja

MESAZH NGA DREJTORJA E PËRGJITHSHME EKZEKUTIVE	5
TË REJAT MË TË FUNDIT	6
PUBLIKIMI I BULETINIT TË TRETË MJEDISOR DHE SOCIAL	9
SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË DHE MJEDISIT	10
ZGJERIMI I AEROPORTIT - FAZA B E NDËRTIMIT	15
MENAXHIMI I SIGURISË DHE SHËNDETIT	16
KLIENTËT	18
STAFI I TIA-S	20
ÇËSHTJET SOCIALE	21
ARRITJET	22



Mesazh nga Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive



Zj. Andrea Gebbeken
Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive
Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës

Të dashur lexues,

Duke u bazuar në suksesin e vitit të shkuar kur Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) priti pasagjerin e njëmiliontë, viti 2008 ishte po aq i suksesshëm dhe i larmishëm sa ai 2007, dhe aeroporti vazhdon të ecë përpara dhe të rritet me ritme të shpejta.

Në fillim të vitit 2008 Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim mori në shqyrtim kërkesën e TIA-s për të financuar zgjerimin e terminalit ekzistues të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës. Në muajt që pasuan, këtij projekti kaq të rëndësishëm që do të çojë përpara standardet e shërbimit jo vetëm të TIA-s por edhe të Shqipërisë, iu dha miratimi. Një marrëveshje kredie u arrit midis TIA-s dhe disa bankave të ndryshme shqiptare e të huaja. Zbatimi i këtij projekti filloi më 25 korrik 2008 dhe do të përfundojë në shtator 2009. Ne besojmë se ky projekt - ose siç e quajmë ne atë faza B - gjatë të cilit terminalit ekzistues të pasagjerëve, do t'i shtohet një terminal i ri, pajisje të teknologjisë së fundit si dhe mjedise të tjera, do të rrisë ndjeshëm shërbimin me cilësi të lartë që aktualisht ofrojmë. Dhe çfarë është më kryesorja, TIA do të ketë mundësi të presë 1.5 milionë pasagjerë në vit.

Midis këtyre statistikave të shkëlqyera TIA ka punuar me shumë përkushtim edhe në çështjen delikate të mjedisit. Ne e dinim që shtimi i kompanive ajrore që operojnë në TIA do ta sillte çështjen e mjedisit në listën e përparësive tona dhe jemi marrë me këtë çështje. TIA nëpërmjet departamentit të saj të Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë zhvilloi një raport audit. Përfundimet e këtij raport audit u publikuan në shkurt të vitit 2008 dhe konfirmuan se punimet që do të zhvillohen gjatë fazës B si dhe veprimtaritë shtesë si pasojë e këtyre punimeve, nuk do të kenë ndonjë efekt mbi mjedisin, shëndetin dhe anën sociale. Ky rezultat nuk vjen vetëm nga trajtimi me kujdes dhe përgjegjësi i çështjes mjedisore nga ana e TIA-s, por edhe si pasojë e bashkëpunimit të ngushtë në këtë çështje midis TIA-s, nënkontraktorëve dhe koncensionarëve, të cilët zhvillojnë aktivitetet e tyre në aeroport.

Cilësia e shërbimit që ne ofrojmë vazhdon të tërheqë interesin e kompanive ajrore të ndryshme prestigjioze. Kompania ajrore greke e fluturimeve, Aegean Airlines iu bashkua listës së kompanive të ndryshme që operojnë nga dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", duke e shtuar këtë numër në 13. Ndërkohë që kompania BelleAir ofron fluturime direkte në destinacione të ndryshme që më parë arriheshin vetëm me anë të fluturimeve tranzit.

Duke qënë e përgjegjshme për pozicionin e saj lider në fushën e biznesit dhe një nyjë lidhëse midis popujve dhe vendeve, qëllimi i TIA-s është të mbështesë, pasurojë dhe zgjerojë jetën kulturore dhe artistike të komunitetit. Aktivitete të ndryshme të këtyre llojeve janë mbajtur në mjediset e saj, përfshi këtu Shkodra Jazz Festival si dhe një sfilatë mode e veçantë ku u paraqitën veshje dhe modele shqiptare. Të dyja këto shfaqje tërhoqën vëmendjen e vizitorëve, punonjësve dhe pasagjerëve.

Përveç aktiviteteve kulturore që janë mbështetur gjatë këtij viti, TIA gjithashtu i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe detyrimeve të saj sociale duke u përfshirë në vepra të ndryshme bamirësie.

Një nga rastet që merr rëndësi të veçantë është ai i tragjedisë së Gërdecit, ku kompania jonë mbështeti financiarisht familjet e katër punonjësve të saj që u prekën nga kjo tragjedi.

Buletini i Tretë Mjedisor dhe Social paraqet rritjet dhe sukseset e arritura nga TIA në mënyrë të qartë dhe transparente, si dhe jep një vështrim për planet e vitit të ardhshëm. Gjithashtu me anë të fakteve dhe shifrave të paraqitura, ky buletin shpreh qartë përkushtimin tonë për një aeroport dhe një Shqipëri më të pastër.

Ju urojmë lexim të këndshëm,



TË REJAT MË TË FUNDIT

Dhjetor 2007

Më 6 dhjetor 2007, numri i pasagjerëve që kaluan në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, për të parën herë në historinë e transportit ajror në Shqipëri, kapi shifrën e 1 milion pasagjerëve. Ky numër pasagjerësh u arrit katër vjet përpara parashikimeve të TIA-s, të cilat ishin bërë gjatë vitit 2005.

Janar 2008

Viti 2007 ishte viti i rekordeve për TIA-n. Numri i pasagjerëve që përdorën aeroportin gjatë vitit 2007 u rrit me 22% krahasuar me një vit më parë, transporti i mallrave u rrit me 65% dhe trafiku ajror me 15%. TIA hyri në vitin 2008 me një infrastrukturë të përmirësuar, përvojë më të madhe dhe pritshmëri më të lartë.

Shkurt 2008

Më 1 shkurt të vitit 2008, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) miratoi një projekt të ri për TIA-n. EBRD ra dakord për të financuar zgjerimin e terminalit të ri të aeroportit. Projekti, i cili do të përfshijë edhe rikonstruksionin e terminalit të vjetër të TIA-s, është parashikuar të kushtojë 28 milionë Euro. Ky zgjerim i parashikuar vjen gjatë kohës kur numri i lëvizjes së pasagjerëve dhe mallrave ka pësuar rritje të ndjeshme, dhe vetëm një vit pas përfundimit të terminalit të ri.

Mars 2008

Nga datat 5 deri 9 mars 2008, TIA ishte pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Berlinit. Aeroporti ka qënë rregullisht i pranishëm në këtë aktivitet ndërkombëtar duke e parë atë si instrument të dobishëm për të tërhequr interesin e të huajve drejt Shqipërisë.

Mars 2008

TIA nënshkruan një marrëveshje kredie me EBRD, Deutsche Investitions- und Entwicklungsgesellschaft, Alpha Bank dhe American Bank of Albania për fazën B të zgjerimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës. Aeroporti mori një hua prej 46.9 milionë Eurosh nga EBRD dhe nga bankat e sipërpërmendura për të financuar zgjerimin e terminalit të ri të pasagjerëve, ngritjen e ndërtesave të reja në aeroport si dhe për të investuar në mjete logjistike. Punimet kanë filluar në verën e vitit 2008 dhe do të përfundojnë në vitin 2009.

Prill 2008

TIA ka një ndërtesë të re administrate. Rikonstruksioni i terminalit të vjetër bëri të mundur krijimin e një ndërtesë moderne administrate, të pajisur me gjithë infrastrukturën dhe mjediset e nevojshme si: zyra, dhoma trajnimi, dhoma takimesh, dhoma sociale, menci, dhomë emergjence si dhe zyra për agjencitë qeveritare dhe palët e treta.

Drejtorja e përgjithshme ekzekutive e TIA-s, Znj. Andrea Gebbeken (në qendër), drejtorja për transportet në BERZH, Znj. Sue Barrett (në të djathtë) dhe ministri i punëve publike, transportit dhe telekomunikacioneve, Z. Sokol Olldashi, gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes së kreditimit, të premtën më 28 mars 2008



Nga e majta në të djathtë Z. Ervin Mazniku drejtor i përgjithshëm i aviacionit civil, Znj. Andrea Gebbeken drejtore e përgjithshme ekzekutive e TIA-s dhe Z. Roland Jaggi shef i menaxhimit të të ardhurave dhe çmimeve në Aegean Airlines, duke prërë shiritin në kalimin e pasagjerëve drejt fluturimit të parë të Aegean Airlines nga Tirana më 19 maj 2008



Maj 2008

Më 19 maj të vitit 2008, gjatë një ceremonie prestigjioze ku të ftuar ishin përfaqësues të medias dhe bizneseve të ndryshme, kompania greke e fluturimeve Aegean Airlines i bashkohet kompanive të tjera që operojnë në TIA. Kompania ofron fluturime ditore midis Tiranës dhe Athinës duke iu ofruar pasagjerëve mundësi të reja në shërbime, çmim dhe komfort.

Qershor 2008

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, më 5 qershor 2008, stafi i TIA-s mbolli pemë përpara zyrës së administratës, duke zgjeruar kështu hapësirën e gjelbër të aeroportit dhe rrjedhimisht duke kontribuar në uljen e ndotjes së ambientit në zonat përreth, si pasojë e operimeve të aeroportit.

Qershor 2008

Kompania e fluturimeve BelleAir fillon fluturimet direkte midis Tiranës dhe Prishtinës. Përrurimi i fluturimeve të rregullta midis kryeqyteteve të dy vendeve u bë gjatë një ceremonie festive, ku të pranishëm ishin të ftuar nga qeveria shqiptare, biznesi dhe media.

Korrik 2008

TIA organizon një ceremoni për të shënuar fillimin e punimeve për modernizimin e mëtejshëm të saj, të quajtur faza B, punime të cilat do të përfundojnë në shtator të vitit 2009. Një ceremoni e rëndësishë së veçantë u mbajt më datën 25 korrik 2008. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin kryeministri shqiptar, përfaqësues të kompanive aksionere të TIA-s, qeveritarë të niveleve të ndryshme, të akredituar të trupit diplomatik në Shqipëri si dhe klasa e biznesit vendas. Kjo fazë e re do të rrisë ndjeshëm kapacitetin përpunues të aeroportit dhe objektivit i saj kryesor do të jetë zgjerimi i terminalit të pasagjerëve.

Koncepti themelor i këtij zgjerimi është njësimi i dy terminaleve, në mënyrë që të përmbushen më së miri nevojat dhe kërkesat e pasagjerëve si dhe të operohet me një efikasitet maksimal. Zgjerimi fizik i terminalit do të përfshijë 14 pika kontrolli biletash të reja, zona për përpunimin e bagazheve, hyrje të reja, tre sportele kompanish ajrore, tre porta daljeje në pistë si dhe zyra të ndryshme në katin e parë.

Raporti i Analizës Mjedisore dhe Auditit i zhvilluar nga TIA konfirmoi se punimet e ndërtimit dhe punimet e tjera nuk do të kenë ndonjë efekt thelbësor mjedisor shëndetësor dhe social.

Gusht 2008

Publikohet numri total i pasagjerëve që kanë kaluar në portat e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës Nënë Tereza i cili është 540.000, dhe tregon një rritje prej 19 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Nga e majta në të djathtë: kryetari i këshillit administrativ të TIA-s dhe drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i HOCHTIEF AirPort Dr. Reinhard Kalenda, kryeministri shqiptar Prof. Dr. Sali Berisha dhe Znj. Andrea Gebbeken, drejtore e përgjithshme ekzekutive e TIA-s, duke hapur brazdën e parë të punimeve për zgjerimin në ceremoninë e mbajtur më 25 korrik 2008 në terren



Aktivitetet kryesore sociale



Maj 2008

Në maj 2008 TIA mbështeti familjet e katër punonjësve të saj për të rindërtuar shtëpitë e tyre pas shpërthimit tragjik të Gërdecit, ku humbën jetën 26 persona dhe dhjetra të tjerë u plagosën. Ky kontribut u përshëndet nga qeveria shqiptare si dhe banorët e Gërdecit.

Qershor 2008

Zhvillohen ndeshje minifutbolli në terminalin e ri, në të cilat merr pjesë personeli i TIA-s dhe pasagjerët. Ethet e kampionatit europian të futbollit sapo kishin filluar, kështu që HOCHTIEF Airport Retail (HTAR), dyqanet, baret dhe restorantet në zonën e aeroportit vendosën dy tavolina minifutbolli dhe ftuan pasagjerët, vizitorët dhe personelin për të luajtur. Promocione të tjera shoqëruan këtë aktivitet duke përfshirë dhe mallrat origjinale të UEFA-s që u shitën në dyqanet e aeroportit.

Qershor 2008

Departamenti i komunikimit të aeroportit dhe Alitalia u vlerësuan në Televizionin Shtetëror Shqiptar (TVSH) më datë 10 qershor, për rolin që luajtën në ndihmën që i dhanë një familjeje shqiptare nga një fshat i Mirditës, vajza 16-vjeçare e së cilës ishte në nevojë urgjente për ndihmë të specializuar mjekësore. Ky akt humanitar u bë publik gjatë një emisioni shumë të ndjekur televiziv të titulluar “Të Kam Zemër”, i cili i kushtohet ndihmës që mund t’u jepet njerëzve në nevojë dhe që u transmetua gjatë orarit më të ndjekur në TVSH.

Familja ishte bërë gati për të udhëtuar në Itali për të shoqëuar vajzën në një spital në Pavia kur hasën në një problem me vizat për Itali. Çdo lloj vonese do të thoshte se vajza do të humbiste mundësinë të trajtohej në kohë dhe në këtë mënyrë jeta e saj do vihej në rrezik.

Ky rast iu soll zyrove të departamentit të komunikimit të TIA-s nga gazetarët e “Të Kam Zemër”. Stafi i TIA-s gjeti një ndihmë të shpejtë e të plotë nga zyrtarët e Alitalias për të kapërcyer këtë problem dhe në më pak se gjysëm ore familja qe në gjendje të vazhdonte udhëtimin e nisur.

Stafi i TIA-s duke luajtur ndeshje minifutbolli në mjediset e terminalit, më 6 qershor 2008



Foto gjatë sfilatës së modës së stilistes së re Manjola Muço Kalaja, organizuar në mjediset e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, më 13 qershor 2008

Qershor 2008

Veshjet e stiluara nga stilistja e re shqiptare Manjola Muço Kalaja e kthyen zonën e nisjeve të terminalit të ri në një pasarelë mode. Znj. Kalaja prezantoi 20 fustane mbrëmjeje duke tërhequr interesin e publikut, admiruesve të modës dhe personelit të TIA-s.

Korrik 2008

Festivali prestigjioz, Shkodra Jazz Festival, tani në edicionin e tij të katërt, vuri në skenë për herë të parë pjesë nga repertori i tij i koncerteve në mjediset e TIA-s, duke sjellë kështu në aeroport dashamirës të shumtë të kësaj muzike, të cilët patën mundësinë të përjetojnë kënaqësinë që sjellin tingujt e pasur të muzikës xhaz në një mjedis modern. Pas një konference për shtyp, u dha një koncert nga banda e famshme italiane Manomanouche për një publik të përbërë nga të ftuar specialë, banorë lokalë, përfaqësues të medias dhe stafi i aeroportit. Pas koncertit, turneu vazhdoi në qytetin e Shkodrës.



Dy artistët e Shkodra Jazz Festival, duke luajtur në mjediset e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, më 3 korrik 2008

PUBLIKIMI I BULETINIT TË TRETË SOCIAL DHE MJEDISOR

Buletini i Tretë Mjedisor dhe Social informon publikun mbi aktivitetet e TIA-s që kryesisht lidhen me zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë dhe Mjedisit si dhe hapave të tjerë të rëndësishëm që janë marrë për të arritur një performancë të suksesshme të kompanisë.

Ky buletin paraqet një pamje të përgjithshme të nismave të ndërmarra nga TIA për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm të aeroportit, përmes një përqasjeje të integruar ku respektohen plotësisht standardet e cilësisë, sigurisë, mjedisit dhe ato të shëndetit.

Respektimi i standardeve nga njëra anë dhe kujdesi i treguar për të arritur një shërbim të cilësisë së lartë nga ana tjetër, e kanë transformuar këtë aeroport në një mjedis të ngrohtë dhe mikpritës për të gjithë klientët; pasagjerët, kompanitë e fluturimeve, partnerët, vizitorët, si dhe për vetë personelin.

Buletini është i publikuar në gjuhën shqipe dhe atë angleze dhe mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit të aeroportit (www.tirana-airport.com).

SISTEMI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT DHE CILËSISË

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës është i fokusuar për të garantuar mjedisë të cilësisë së lartë, siguri dhe komfort, të cilat plotësojnë dëshirat dhe kërkesat e klientëve. Mbrojtja e mjedisit është një pjesë përbërëse e strategjisë së korporatës së aeroportit. TIA si një kompani e përparuar, e përgjegjshme për mjedisin është e përkushtuar të sigurojë që veprimtaritë që zhvillohen në aeroport të kenë ndikimin më të vogël të mundshëm në mjedis dhe në komunitetin lokal. Gjithashtu, TIA inkurajon klientët dhe partnerët që të mendojnë për mjedisin dhe ta mbrojnë atë.

Aeroporti zbaton një sistem efektiv të Menaxhimit të Cilësisë dhe Mjedisit dhe departamenti i tij respektiv gjithnjë i përmbush detyrat në lidhje me sistemin që mban, duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimit në aeroport, respektimin e standardeve mjedisore, sistemin e menaxhimit të mjedisit, detyrimet mbi shëndetin dhe sigurinë në punë. Njëkohësisht departamenti mat, monitoron, regjistron dhe raporton në lidhje me këto çështje.

Audite mjedisore të brendshme, si dhe inspekte të tjera zhvillohen rregullisht në aeroport, në mënyrë që të sigurohet që procedurat dhe praktikatat po zbatohen dhe respektohen plotësisht. Në të njëjtën kohë, kryhen dhe monitorime mbi performancën për të kontrolluar përmbushjen e objektivave në përputhje me Marrëveshjen e Konkensionit, Politikën e Cilësisë dhe Politikën e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë, në mënyrë që të merren masa korrigjuese ose parandaluese në qoftë se ato janë të nevojshme.

Procedurat mjedisore si dhe Programi Monitorues i Ndërtimit për Mbrojtjen e Mjedisit u përpiluan, rishikuan dhe pasuruan në fillim të vitit 2008, ndërsa shpërndarja, kuptimi dhe zbatimi i procedurave respektive nga i gjithë personeli i TIA-s zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme.

Programi monitorues mjedisor i TIA-s, i cili përfshin zhurmat, monitormin e ujit dhe ajrit, zhvillohet në përputhshmëri të plotë me procedurat e monitorimit dhe menaxhimit. Aktualisht, aktivitetet në TIA janë në përputhje të plotë me kërkesat dhe standardet rregullatore, dhe nuk kanë asnjë efekt negativ si në mjedis ashtu dhe në shëndetin njerëzor.

Në përputhje me ligjet shqiptare të mjedisit, TIA i ka dorëzuar një raport monitorues Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Ky raport përmban rezultatet e vetëmonitorimit mbi nivelin e zhurmave, ajrin dhe ujërat e zeza dhe të dhënat që dalin prej tij janë në përputhje të plotë me standardet e kërkuara shqiptare, si dhe ato të Komunitetit Europian dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Zbatimi i Planit të Veprimit të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë, dhe Social

Plani pesë vjeçar i veprimit të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë, dhe Social 2005-2010 u rifreskua dhe detajua më tej duke pasur në qendër të vëmendjes fazën B për zgjerimin e aeroportit dhe vendosi objektivat për t'u arritur, duke përfshirë dhe këto më poshtë:

- Zbatimin e Planit të Menaxhimit të Sistemit të Cilësisë dhe Mjedisit si dhe rishikimin e manualeve dhe procedurave
- Cilësinë e ajrit dhe kontrollin e përdorimit të karburanteve
- Cilësinë e ujit dhe kontrollin e përdorimit të tij
- Përmirësimin e sistemit kullues
- Monitorimin e zhurmave dhe llogaritjen e kontureve të zhurmave
- Reduktimin dhe hedhjen e mbeturinave në mënyrën e duhur
- Pajisjen e personelit me pajisje personale mbrojtëse
- Trajnimin dhe aktivitetet ndërgjegjësuere

Menaxhimi i cilësisë së ajrit

Ndotja më e madhe e ajrit në aeroport vjen nga çlirimi i gazrave të avionëve, si dhe aktivitetet e tjera që zhvillohen brenda tij, si trafiku rrugor, automjetet që lëvizin në aeroport, si dhe aktivitetet që kanë lidhje me prodhimin dhe konsumimin e energjisë. Ndotësit kryesorë që mund të kenë një impakt në shëndetin njerëzor dhe në mjedis janë PM_{10} , SO_2 , CO , O_3 , NO_2 dhe plumbi (Pb).







TIA ka nënkontraktuar laboratorin e specializuar të Institutit të Shëndetit Publik për të monitoruar këto parametra nga datat 17 deri më 30 qershor 2008. Ky monitorim u zhvillua në mjediset e brendshme dhe të jashtme të aeroportit. Rezultatet treguan se TIA operon në përputhje të plotë me standardet shqiptare dhe ato të Bashkimit Europian (shih tabelën 1, grafikët).

Për të mbajtur dhe përmirësuar një cilësi të standardeve të larta të ajrit në zonën e aeroportit dhe rrethinat e tij si dhe për të mbrojtur shëndetin e publikut, TIA ka marrë disa masa duke përfshirë dhe këto më poshtë:

- Modernizimi i procesit të punës duke blerë dhe instaluar pajisje dhe automjete të reja
- Ndërtimi i një vendparkimi të ri në ndërtesën e administratës
- Inkurajimi i personelit dhe pasagjerëve për të përdorur transportin publik

Tabela1. Rezultatet e monitorimit të ajrit 2008

Ndotja	Terminal	Pistë	Limiti shqiptar	Limiti i EU
SO_2 ($\mu g/m^3$)	3,8	4,6	60	50
NO_2 ($\mu g/m^3$)	15,5	21,7	50	40
CO ($\mu g/m^3$)	1,2	2,5	6	6
PM_{10} ($\mu g/m^3$)	16,8	22,8	70	40
Pb ($\mu g/m^3$)	-	0,61	1	0,5
O_3 ($\mu g/m^3$)	-	82	120	110



Skema për këmbimin e gazrave të çliruara dhe Deklarata e Pozicionimit

Një konferencë me temë “Ndryshimet klimaterike dhe impakti i tyre në aviacion” u organizua me ekspertët e mjedisit nga HOCHTIEF AirPort dhe aksionerët e tij. Qëllimi i kësaj konference ishte njohja me zhvillimet më të fundit në këtë fushë. Fokusi kryesor ishte tek rezultatet e kërkimeve mbi ndryshimet klimaterike, si dhe pikëpamjet e qëndrimet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare të aviacionit civil. Në fund konferenca doli me një “Deklaratë Pozicionimi” në të cilën u rradhitën çështjet më kryesore në lidhje me ndikimin që kanë ndryshimet klimaterike në aviacion. Duke patur parasysh që ndikimi global i aviacionit në ndryshimet klimaterike është relativisht i vogël, një nga përfundimet që u arrit, ishte ai që propozimet dhe masat mund të merren lokalisht. Masa si vendosja e tarifave për shkarkimin e gazrave, cilësohet si e nevojshme, por ajo duhet të zbatohet në nivel global dhe pjesë e këtij sistemi duhet të jenë të gjitha kompanitë e fluturimeve.

Stafi drejtues i TIA-s firmosi këtë deklaratë duke shprehur pozicionimin e të gjithë aeroporteve që menaxhohen nga HOCHTIEF AirPort.

Menaxhimi i ujërave

Aktivitetet kryesore në lidhje me menaxhimin e ujërave këtë vit kanë qënë furnizimi me ujë të pijshëm, kontrolli i konsumit të ujit, si dhe monitorimi dhe trajtimi i ujërave të zeza.

Uji i pijshëm

Aeroporti furnizohet me ujë nga dy puse. Njëri furnizon me ujë të pijshëm pas trajtimit në impiantin e posaçëm, ndërsa tjetri furnizon me ujë për vaditje dhe qëllime të tjera.

TIA ka vendosur filtra uji në impiantin e përpunimit të ujit të pijshëm, më qëllim që cilësia e këtij uji të jetë e lartë. Gjithashtu ajo ka instaluar matësa uji për të kontrolluar dhe menaxhuar sa më mirë konsumin e tij. Rezultatet tregojnë se në aeroport konsumohen 60 m³ ujë në ditë.

Në përputhje me ligjet shqiptare mbi shëndetin dhe respektimin e procedurave Pro 007QEHS mbi monitorimin e cilësisë së ujit, TIA ka bërë testet, analizat fizike, kimike dhe bakteoreologjike të ujit të pijshëm në aeroport. Këto teste dhe analiza janë bërë në vazhdimësi nga Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Inspektorati Sanitar i Tiranës.

Duke iu referuar raportit të këtij institucioni standardet shqiptare mbi ujin e pijshëm (STASH 3904:1997) janë plotësuar tërësisht, dhe uji që furnizohet nga pusët është i pastër dhe i sigurt për konsum nga njerëzit.

Ujërat tokësore dhe ato nëntokësore

Në aeroport është ngritur një sistem kullimi i cili është i ndarë nga ai i ujërave të zeza. Ujërat e shiut që vijnë nga pista e aeroportit, rrugët, tarracat, etj. mblidhen në sistemin e kullimit të ujërave sipërfaqësorë. Më pas uji trajtohet mekanikisht në sistemin e ndarësve të vajrave përpara se ato të derdhen në sistemin e kanalizimit të ujërave sipërfaqësorë. Sistemi i kullimit u përmirësua në vitin 2007 dhe do të zgjerohet në zonat ku do të ndërtohen godina të reja (si pika e re e furnizimit me karburant), dhe kur do të shtohen aktivitetet të tjera.

Ujërat e zeza

TIA është kompania e parë private në Shqipëri e cila ka instaluar një impiant të trajtimit të ujërave të zeza. Ky impiant filloi punën në korrik të vitit 2007 dhe purifikon ujërat e zeza që mblidhen nga terminali i pasagjerëve, administrata dhe zyrat e tjera të TIA-s si dhe nga avionët. Impianti ka një kapacitet trajtimi të ujërave të zeza prej 130 m³ në ditë përpara se ato të derdhen përfundimisht në lumin Tërkuzë.

Gjatë dimrit, në periudha të shkurtra, për shkrirjen e akullit, TIA përdor substanca me bazë propelen glicoli që nuk e dëmtojnë mjedisin. Kompania respekton rregullat e sigurisë në përputhje me (2001/58/EC) mbi marrjen në dorëzim, magazinimin, dhe asgjësimin, në ato raste që është e nevojshme.



Instituti i Shëndetit Publik monitoron rregullisht ujërat e zeza të TIA-s për parametrat e kërkuara të kërkesës biologjike për oksigjen (BOD), kërkesës kimike për oksigjen (COD), lëndës totale pezull (SS). Rezultatet tregojnë se cilësia e ujërave që derdhen në lumin Tërkuzë është në përputhje të plotë me parametrat shqiptare dhe ato të Bashkimit Europian.

Menaxhimi i zhurmave

Gjatë tre dekadave të fundit, numri i fluturimeve të avionëve civil në të gjithë botën është rritur me hapa galopantë dhe numri i pasagjerëve është katërfishuar duke e çuar numrin total në rreth 1.5 miliardë pasagjerë në vit. Duke parë këtë rritje të madhe janë prodhuar shumë lloje avionësh dhe motorësh me nivel të ulët zhurmash. Sidoqoftë impakti i avionëve në mjedis përfshi këtu dhe zhurmat, mbetet përsëri një çështje e rëndësishme.

Për të dytin vit radhazi, TIA monitoroi nivelin e zhurmave në aeroport. Monitorimi u zhvillua në muajin korrik 2008 me mbështetjen e ekspertëve të kësaj fushe nga aeroporti i Hamburgut. Qëllimi i këtij monitorimi ishte matja e niveleve mesatare të zhurmave gjatë ditës në mjediset e brendshme dhe të jashtme të aeroportit.

Matjet u zhvilluan në 12 pika të ndryshme (shih fig.1) përfshi këtu dhe terminalin e ri. Për të përmbushur kërkesat rregullatore këto pika u zgjedhën në varësi të burimeve të zhurmave dhe afërsisë me rrethinat dhe godinat e aeroportit. Dy matje u kryen në pikat ku u mat një vit më parë ose në afërsi tyre. Për të përcaktuar nivelet e zhurmave në mjedis, u rregjistruan dhe u llogaritën niveli ekuivalent i zhurmës (Laeq) si dhe niveli maksimal i zhurmës (Lasmax) gjatë ditës.



Asnjë nivel ekuivalent zhurmë mbi 65 db(A) nuk u rregjistrua jashtë perimetrit të aeroportit, gjë e cila është në përputhje të plotë me ligjet gjermane dhe europiane mbi përmirësimin e mbrojtjes nga zhurmat e avionëve në rrethinat e aeroporteve. Niveli maksimal i zhurmave që u rregjistrua në të dy kahet e pistës varionte nga 73 deri në 92 db(A), në varësi të tipit të avionit. Mesatarja ditore e këtyre zhurmave varionte midis 48-60 db(A).

Përfundimi i këtyre matjeve tregoi se TIA operon në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

Figura 1. Vendndodhja e dymbëdhjetë pikave ku TIA zhvilloi matjet e nivelit të zhurmave

Ekspertiza e aeroportit të Hamburgut tashmë po përdoret që t'i vijë në ndihmë TIA-s për të zhvilluar konturet e zhurmave në aeroport, duke shërbyer kështu me të dhëna shtesë për studimin pjesor urban të zonës përreth.

Menaxhimi i mbetjeve

TIA ka zbatuar një plan për menaxhimin e mbetjeve si dhe ka instaluar një sistem menaxhimi për riciklimin, magazinimin e duhur dhe largimin e mbetjeve të rrezikshme. Mbetjet të cilat gjenerohen nga TIA cilësohen si mbetje urbane, mbetje të riciklueshme (letër, karton, plastikë, kanaçe, dru) si dhe mbetje të rrezikshme (vaj i përdorur, bateri, goma, detergjentë, materiale elektronike). Duke patur parasysh këto mbetje, TIA ka përgatitur dhe u ka shpërndarë të gjithë përdoruesve të aeroportit si dhe palëve të treta një set Rregulloresh dhe Instruksionesh për Mbetjet.

Për më tepër, TIA ka kontraktuar kompani të specializuara në mbledhjen dhe përpunimin e mbetjeve, të licensuara nga autoritetet shqiptare, të cilat operojnë në përputhje me kuadrin rregullator dhe standardet në fuqi respektivisht për mbledhjen, transportin dhe hedhjen e mbetjeve urbane, mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve të riciklueshme, si dhe mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme.

Gjatë vitit 2007 u mbledh një sasi midis 25 dhe 30 m³ mbetjesh në ditë nga të cilat 25 deri në 30 përqind ishin mbeturina të riciklueshme. Mbetjet dhe substancat e rrezikshme që dalin nga TIA magazinohen përkohësisht në përputhje të plotë me Ligjin shqiptar Nr. 9537, të datës 18 maj 2006 “Mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

Kompania e specializuar shqiptare për mbledhjen e vajrave të përdorur gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008, i ka mbledhur TIA-s 500 litra vaj të përdorur që ishte magazinuar në mjediset e TIA-s. Në bashkëpunim me departamentin e shërbimit të aeroportit, kompania e mirëmbajtjes FMS Shpk po trajton sasinë vjetore të materialeve të përdorura si dhe të substancave të konsideruara si të rrezikshme, të cilat gjenerohen në aeroport.

Mjedisi natyror

Më shumë se gjysma e hapësirës së Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza mbulohet nga zona të gjelbëra. Përdorimi i mjediseve të saj kërkon që të respektohen rregullat dhe kërkesat e sigurisë ajrore në menaxhimin e hapësirave të gjelbëra të aeroportit. Hapësirat e gjelbëra që janë në afërsi të zonave të lëvizjes së avionëve mbahen në një lartësi mbi 20-30 cm për të ulur numrin e zogjve të cilët preferojnë zona të qeta me bimësi të ulët për t'u shumuar dhe ushqyer. Kështu që shumica e hapësirave të gjelbëra të aeroportit korren dy herë në vit.

Punimet për peisazhin dhe kopshtarinë i janë nënkontraktuar kompanive të specializuara. Pemë ulliri dhe palma dekorojnë peisazhin në hyrje të aeroportit, si dhe disa pemë bliri janë mbjellë në zonën e parkimit të ndërtesës së administratës.

Familjet e shpendëve që jetojnë në zonën e aeroportit vëzhgohen dhe numërohen rregullisht dhe përbëhen nga harabeli, petriti, bufi etj.



ZGJERIMI I AEROPORTIT - FAZA B E NDËRTIMIT

Faza B e punimeve për zgjerimin e aeroportit konsiston në ndërtimin e një godine njëkatëshe e cila lidhet në anën veriore me terminalin ekzistues dhe është 30 metra e gjerë.

Ky zgjerim do të përfshijë katërmëdhjetë pika kontrolli shtesë (check-in), zona të reja për përpunimin e bagazheve, hyrje të reja, tre sportele të reja kompanish ajrore, tre porta me dalje nga pista, si dhe zyra të reja shtesë dhe pajisje teknike në katin e parë.

Zgjerimi total, shprehur në terma të njollës së ndërtimit, përfaqëson rreth 42 përqind të terminalit ekzistues me rreth 11,300 m² në katin përthjes dhe 1,250 m² në katin e parë. Për zonën e mbërritjeve në terminal nuk është planifikuar zgjerim i strukturës ekzistuese të ndërtesës.

Gjatë fazës B gjithashtu do të zhvillohen edhe disa projekte të tjera shtesë të cilat do të fokusohen në mbështetjen e operacioneve të aeroportit, përmirësimin e stacionit të zjarrfikseve, përgatitjen e rilokimit të pikës së furnizimit me karburant, zgjatjen e vendparkimit të avionëve, investimeve në fushën e aeroportit dhe në instalimin e pajisjeve dhe sistemeve shtesë.

Faza B filloi në korrik 2008 dhe do të mbarojë në shtator 2009. Zgjerimi i terminalit të pasagjerëve do të rrisë në mënyrë të ndjeshme kapacitetin e aeroportit, duke bërë të mundur pritjen e deri 1.5 milionë pasagjerëve në vit. TIA ndërkohë do t'i qëndrojë besnikë zotimeve të saj për të operuar brenda një zone të sigurtë dhe të qetë, duke u përfshirë edhe në zhvillimin social të zonës.

Analiza mjedisore dhe raporti i auditit

Gjatë përgatitjeve për fazën B në janar të vitit 2008, TIA përgatiti një raport auditit dhe analize mjedisore. Raporti rishqyrtoi statusin mjedisor ekzistues dhe identifikoi efektin e mundshëm që mund të ketë në mjedis zgjerimi i aeroportit, si dhe u hartua një plan për të parandaluar ndonjë pasojë të mundshme përpara fillimit të fazës B. Analiza mjedisore verifikoi se nuk ka ndonjë pasojë të konsiderueshme mjedisore apo sociale.

Ky raport i shqyrtuar nga huadhënësit përfshi këtu dhe EBRD, tregoi se TIA e ka zbatuar më së miri Planin e Veprimit të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë, dhe Social. Gjithashtu, zhvillimin e aktivitetit, TIA e ka realizuar në përputhje të plotë me kërkesat aktuale vendase dhe të Bashkimit Europian për sigurinë, shëndetin dhe shoqërinë.

Publikimi i përmbledhjes së kontrollit mjedisor:

Faza B-Koncensionit i aeroportit të Tiranës.

Në njoftimin që bëhet për publikimin e Përmbledhjes të Rishikimit Mjedisor: Projekti për Fazën B - të koncensionit të aeroportit të Tiranës, në përputhje edhe me politikën mjedisore të EBRD, është klasifikuar si B/1, me ndikime të kufizuara negative mbi mjedisin dhe me masa lehtësuese të përcaktuara mirë. Përmbledhja e Rishikimit Mjedisor që përmban kontrollin e ndërmarrë, rezultatet dhe rreziqet e mbetura si dhe kërkesat për zbatimin e projektit është vendosur në mjedise të hapura për publikun si më poshtë:

- tabela e lajmërimeve në ndërtesën e terminalit të pasagjerëve
- zyrat administrative të TIA-s

Përmbledhja e Rishikimit Mjedisor është vendosur gjithashtu në faqen e internetit të TIA-s në adresën www.tirana-airport.com në versionin anglisht dhe shqip, si dhe në faqen e internetit të EBRD në www.ebrd.com. Një njoftim mbi publikimin e përmbledhjes së Rishikimit Mjedisor, është botuar në gazetën shqiptare më datë 8 shkurt 2008.

MENAXHIMI I SIGURISË DHE SHËNDETIT

Manuali i TIA-s mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë

Manuali i TIA-s mbi Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë jep udhëzime të plota dhe të qarta për procedurat e sistemit të sigurisë që duhen ndjekur gjatë punës në pistë.

Monitorimi i zbatimit të standardeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të parë efikasitetin e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Cilësisë, Mjedisit e Sigurisë. Çdo rast shkeljeje, identifikohet, kontrollohet, raportohet, korrigjohet dhe dokumentohet.

Përpjekjet më të mëdha janë përqëndruar për të marrë masa sa më efikase për të parandaluar incidentet ose aksidentet. Përveç trajnimeve të shumta, rritjes së ndërgjegjësimit, dhe hartimit të procedurave, masa janë marrë për shpërndarjen, shpjegimin dhe zbatimin e procedurave, më qëllim që të minimizohet risku i gabimeve.

Plani i emergjencës së aeroportit

Qëllimi kryesor i planit të emergjencës së aeroportit është që të mundësojë një dokument të kompletuar funksional, i cili do t'u vijë në ndihmë personelit dhe agjencive përkatëse për të zgjidhur me efikasitet situatat e emergjencave. Ky dokument përcakton qartë detyrat dhe masat që duhen marrë nga të gjitha agjencitë që përfshihen në një rast të mundshëm emergjence në aeroport.

Stafi është trajnuar në lidhje me emergjencat, sipas planit të emergjencave dhe menaxhimit të krizave. Stafi i zjarrfikësve dhe ai i shpëtimit veprojnë në mënyrë profesionale dhe një dhomë e re emergjence është ndërtuar për të përballuar emergjencat e mundshme.

Zjarrfikësit

Duke u bazuar në standardet e IATA/ICAO, TIA operon si një aeroport i kategorisë së 7 në lidhje me zjarrin.

Në vitin 2007, TIA i shtoi stacionit të saj të zjarrfikësve një zjarrfikëse të re, që në rastet e nevojshme t'u vijë në ndihmë atyre dy ekzistuese. Stafi i TIA-s është i trajnuar nga ekspertët e aeroportit të Dusseldorf-it, si dhe është i pajisur me uniforma të reja dhe të gjitha mjetet mbrojtëse. Si masë tjetër mbrojtëse kundër zjarrit këtë vit terminali i ri u pajis me një sistem zbulimi dhe fikje zjarri automatik, ndërsa një sistem i ri hidrantësh është instaluar në aeroport.



Mbrojtja ndaj rrezatimit

Në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 8525 të datës 9.11.1995 "Mbi Mbrojtjen nga Rrezatimi", TIA ka përgatitur dhe dorëzuar pranë Zyrës për Mbrojtjen nga Rrezatimi gjithë dokumentacionin për sigurimin e licensës e cila lëshohet nga Instituti i Shëndetit Publik.

Ashtu siç kërkohet nga ligji, si dhe në bazë të Planit të Emergjencave të Aeroportit, TIA ka marrë një numër masash parandaluese për mbrojtjen nga rrezatimi, përfshi këtu dhe këto të mëposhtmet:

- Nënshkrimi i një marrëveshjeje shërbimi midis TIA-s dhe Institutit të Fizikës Bërthamore për të monitoruar dhe vëzhguar ekspozimin ndaj rrezatimit të stafit gjatë punës.

- Emërimi i një prej anëtarëve të stafit të TIA-s si përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimi.
- Monitorimi mujor i nivelit të rrezatimit gjatë operacionit të skanerave.
- Përgatitja e një plani emergjence për mbrojtjen ndaj rrezatimit.
- Dokumentimi i të dhënave të të gjitha pajisjeve, dokumentet mjekësore të personelit, të dhënat e dozimetrave, të dhënat e incidenteve etj.
- Trajtime për stafin e kompanisë ICTS Shpk, përgjegjëse për sigurinë në aeroport me temë "Rrezatimi dhe Masat Mbrojtëse" ku janë trajnuar më shumë se 100 punonjës.

Përfshirja e TIA-s në zhvillimet më të fundit në Bashkimin European mbi sigurinë në aviacion

TIA mori pjesë në një studim të ACI (Këshillit Ndërkombëtar të Aeroporteve) për Europën mbi madhësinë e bagazheve, në lidhje me Direktivën e Bashkimit European që kufizon madhësinë e bagazheve të dorës për arsye sigurie. Ky studim u zhvillua nën menaxhimin e Fraport (Aeroporti i Frankfurtit) në 15 aeroporte të Europës, dhe iu prezantua Komisionit European në dhjetor të vitit 2007. Studimi mundësoi kontrollin e proceseve të tjera të sigurisë si sjellja e personelit, inspektimi me imtësi mbi sigurinë dhe shpërndarja e personelit.



Shëndeti dhe siguria e personelit të TIA-s

Personeli i Ndhmës së Shpejtë në TIA është i trajnuar plotësisht dhe i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. Ky departament ka përbushur në mënyrë të shkëlqyer detyrimet e tij mbi shëndetin dhe sigurinë për personelin e TIA-s si dhe detyrimet e tjera.

Disa nga trajnimet që i ofrohen personelit të TIA-s përfshijnë trajnime në ndihmën e parë, sigurinë në punë, menaxhimin e materialeve të rrezikshme si dhe trajnim special për personelin e ndihmës së shpejtë.

Stafi është i pajisur me gjithë pajisjet mbrojtëse personale që kërkohen nga standardet europiane në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë dhe është trajnuar mbi rëndësinë e përdorimit në mënyrën e duhur.

Për të mundësuar një mjedis të shëndetshëm për personelin dhe klientët, si dhe për të qenë në përputhje me ligjin mbi shëndetin dhe sigurinë, monitorimi i ajrit dhe zhurmave është bërë në mjediset e jashtme dhe të brendshme të ndërtesës së terminalit. Rezultatet e monitorimit tregojnë se standardet respektohen dhe një mjedis i duhur për të punuar u ofrohet gjithë personelit dhe klientëve.

Një hap i rëndësishëm që duhet përmendur është paraqitja e formateve të reja për të raportuar aksidentet dhe incidentet, apo aksidentet e konsiderueshme.

Shëndeti dhe siguria në objektin e ndërtimit

Inspektime në terren dhe vëzhgime janë kryer gjatë punimeve për rikonstruksionin e terminalit të vjetër në një ndërtesë të re për zyrat e administratës, dhe së fundmi gjatë punimeve të projektit të fazës B. Kjo bëhet për të siguruar zbatimin e plotë të Programit të Monitorimit të Ndërtimeve për Mbrojtjen e Mjedisit si edhe të Planit të Veprimit për Mjedisin Shëndetin, Sigurinë dhe Social. Përfundimet tregojnë se stafi i TIA-s dhe kompania e ndërtimit punojnë në zbatim të plotë të këtyre dokumentave, si dhe kuadrit rregullator në fuqi.

Numri i aksidenteve

Për të parandaluar aksidentet dhe incidentet në punë, nga ana e TIA-s janë marrë masat e duhura për trajnimin e stafit, sigurimin e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm, shpjegimin dhe zbatimin në mënyrën e duhur të procedurave të operimit, si dhe një koordinim i mirë i këtyre operacioneve. Si rezultat i këtyre masave efektive të marra nga TIA dhe duke konsideruar rritjen në volumen e trafikut dhe punimet e ndërtimit të cilat janë kryer paralelisht me operacionet normale të kompanisë, numri i aksidenteve ka qenë zero.



KLIENTËT



Klientët e aeroportit dhe Analiza e Shërbimit

Politika e cilësisë së TIA-s synon sigurimin e mjediseve sipas standardeve të larta ndërkombëtare, siguri dhe komfort, si dhe fokusohet në përmbushjen e kërkesave të klientëve. Një nga qëllimet kryesore të kësaj politike është që të ndërtojë një kulturë pozitive të cilësisë dhe sigurisë, duke siguruar që objektivat e cilësisë dhe sigurisë të kuptohen dhe të zbatohen në të gjitha nivelet e organizimit të kompanisë.

TIA ka realizuar me kujdes identifikimin e klientëve të saj, si kompanitë e fluturimeve (klientët kryesorë), pasagjerëve (grupi më i madh i klientëve), koncensionarëve dhe palëve të treta, vizitorëve dhe personelit si dhe shërbimeve kryesore, mjediseve dhe hapësirave që u nevojiten atyre me qëllim lehtësimin e kuptimit më të mirë të proceseve të ndryshme nëpërmjet të cilave duhet të arrihet një shërbim i cilësisë së lartë.

Anketimi mbi nivelin e kënaqësisë së klientëve

TIA duhet të sigurojë që mjedisi, pajisjet, dhe stafi i saj të jenë gjithnjë të gatshëm për të përmbushur plotësisht detyrat e tyre, si dhe të tregojnë aftësitë e veta për të ofruar në mënyrë të përhershme një shërbim që kënaq kërkesat dhe pritshmëritë e klientëve. Për të dytin vit radhazi, TIA ka zhvilluar një anketim për nivelin e kënaqësisë së klientëve për të kontrolluar nivelin e shërbimit të ofruar.

Ashtu si anketimi i parë i vitit 2007, Anketimi mbi Nivelin e Kënaqësisë së Klientëve 2008 u ideua nga TIA dhe u zhvillua nga një kompani e pavarur me qëllim marrjen e përshtypjeve nga klientët e aeroportit.



Qëllimi kryesor ishte marrja e të dhënave se si klientët vlerësonin gatishmërinë, shpejtësinë e cilësinë e shërbimeve, dhe mjediset që TIA ofron. Një numër prej 1000 pasagjerësh të kategorive të ndryshme u intervistuan. Pothuajse të gjithë treguesit e performancës u vlerësuan si “të shkëlqyeshëm ose shumë të mirë”.

Opinionet, pritshmëritë dhe sugjerimet e klientëve

Në zbatim të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë me anë të kartave të përshtypjeve merren të dhëna nga pasagjerët që fluturojnë nga aeroporti, duke u dhënë kështu mundësinë që ata të shprehin opinionet dhe përshtypjet e tyre mbi shërbimet e ofruara në aeroport, dhe si mund të përmirësohen ato. Kutitë me kartat e komenteve janë të vendosura në terminalin e ri. Gjithashtu, karta e komenteve në gjuhën shqipe dhe atë angleze mund të gjendet edhe në faqen e internetit të TIA-s (www.tirana-airport.com). Në këtë mënyrë TIA ka mundësuar mbledhjen e opinionëve në mënyrë të vazhdueshme.



Takime me përdoruesit e aeroportit

Përveç anketimeve dhe kartave të komenteve, TIA i konsideron si shumë të rëndësishme takimet me përfaqësuesit e shoqërive ajrore si klientët kryesorë të aeroportit, të cilëve gjithashtu u jepen pyetësorë. Për më tepër, TIA është një pjesëmarrës aktiv në takimet e Komitetit të Operatorëve Ajror. Ndërsa një komunikim konstruktiv i vazhdueshëm mbahet me të gjithë aktorët, komunitetin, autoritetet shtetërore si dhe palët e tjera që operojnë në aeroport.

Zbatimi i standardeve të mjedisit, sigurisë dhe komfortit

Me anë të një monitorimi të kujdesshëm TIA identifikon prioritetet e klientëve dhe synon të ofrojë të gjitha shërbimet e domosdoshme dhe të kërkuara që plotësojnë kërkesat e tyre. Në të njëjtën kohë, për të zbatuar standardet e mjediseve, sigurisë dhe komfortit për pasagjerët, TIA monitoron në mënyrë të vazhdueshme standardet e performancës së saj.



STAFI I TIA-S

Një mjedis i këndshëm pune, kujdes i treguar për shëndetin dhe sigurinë në punë, stimulimi i punës në grup, motivimi i personelit, mundësitë për trajnim, transparenca dhe komunikimi, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare, ndarja e roleve dhe e përgjegjësisë apo përcaktimi i kompetencave, janë që të gjitha në qendër të vëmendjes për ekipin drejtues të TIA-s.

Siç është përmendur më sipër në seksionin e të rejave më të fundit, që nga muaji mars i vitit 2008, personeli i administratës së TIA-s ka një ndërtesë të re (ish terminali i vjetër i rikonstruktuar). Kjo ndërtesë ofron zyra të reja, dhoma takimesh, dhoma trajnimesh, menci etj. Ndërtesa e re e administratës si dhe ndërtesa e terminalit të mallrave janë të pajisura me të gjitha mjetet e ndihmës së shpejtë, ndërsa në terminalin e ri janë shtuar mjedise të reja sociale.

TIA ka mundësuar për stafin e saj një autobus falas që operon disa herë në ditë me orare të ndryshme në varësi të turneve, nga qendra e Tiranës drejt aeroportit dhe në drejtim të kundërt. Për më tepër, TIA u jep një kompensim mujor atyre punonjësve që vijnë nga larg.

Vetëndërgjegjësimi dhe trajnimet

Një nga faktorët kryesorë që kontribuon në një performancë të mirë të TIA-s është dhe procesi i trajnimit. Nevojat për trajnim të stafit identifikohen, merren në shqyrtim si dhe trajnimet mundësohen në varësi të pozicionit dhe përgjegjësisë që stafi ka. Një kujdes i veçantë është treguar për trajnimin e stafit për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, Mjedisit dhe Sigurisë.

TIA zyrtarisht ka miratuar politikat e rekrutimit e trajnimit, të cilat kanë filluar të zbatohen nga data 1 tetor 2007. Gjithashtu ka hartuar një strategji për të identifikuar nevojat kryesore për trajnim të stafit, në varësi të pozicionit që ato mbajnë dhe detyrave që u kërkohen.

Politika e rekrutimit garanton shqyrtimin në mënyrë të drejtë të kërkesave për punë dhe rekrutimin e stafit me aftësitë më të mira, shoqëruar me ide të reja për pozicionin që ofrohet. Gjithashtu, politika e trajnimit ofron standarde dhe praktika të barabarta për zbatimin e rregullores së trajnimit të personelit.

TIA ka zhvilluar një skemë për trajnimet e nevojshme e cila shqyrtohet në fund të çdo viti financiar dhe i bashkëngjitet buxhetit. Ky proces i mirëorganizuar dhe transparent i jep mundësi të gjithë personelit të saj të marrë pjesë në trajnimet e duhura.

Trajnimi që bazohet në natyrën dhe cilësinë e secilit pozicion konsiderohet si shumë i rëndësishëm për pjesëtarët e personelit. Trajnimi i personelit të ri, trajnimet e reja për personelin ekzistues, promovimi dhe organizimi i trajnimeve në detyrë si dhe trajnimi i stafit trajnues janë shtyllat kryesore të rregullores së trajnimit në TIA. Kjo krijon një kuptim të integruar për trajnimin, si një mjet për ngritjen profesionale të personelit dhe përmirësimin e kompanisë me anë të zhvillimit.

Trajnimet mbi sigurinë dhe vetëndërgjegjësimin

Bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim dhe në zbatim të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë të TIA-s, është përgatitur një modul mbi Trajnime mbi Sigurinë dhe Vetëndërgjegjësimin me trajnime për personelin e TIA-s dhe palët e treta. Gjithashtu, TIA ka përgatitur një broshurë, “Instruksionet mbi Sigurinë në Pistë” e cila ofrohet në dy gjuhë, atë shqipe dhe angleze, dhe i mundësohet çdo personi që hyn në pistë.

Përveç trajnimit të personelit të TIA-s, kujdes i kushtohet dhe trajnimit të palëve të treta të cilat trajnohen në çështjet e shëndetit, sigurisë si dhe të mirëmbajtjes.

ÇËSHTJET SOCIALE

Mundësitë e punësimit për banorët zonës

Me anë të një politike të ndjekur nga TIA për inkurajimin dhe punësimin e banorëve të zonës, 74 nga 271 (27.3 përqind) e punonjësve të saj vijnë nga zonat rreth aeroportit, Rinas, Krujë, Nikël, Prezë, Qerekë.

Barazia gjinore

Një çështje thelbësore në TIA është barazia gjinore. Rreth 37 përqind e punonjësve të kompanisë janë femra, ndërsa në ekipin e menaxherëve dhe drejtuesve, femrat arrijnë shifrën prej 58 përqind.

Bashkëpunimi me komunitetin lokal dhe autoritetet

TIA ka luajtur një rol të madh për të krijuar një vizion të qartë dhe të kuptueshëm për gjithë aktorët e saj për të arritur një zhvillim të koordinuar të zonës përreth aeroportit, gjetjen e drejtimeve dhe pikësynimeve të rëndësishme.

TIA bashkëpunon ngushtë me të gjitha komunat në afërsi të aeroportit, si dhe ka ndërtuar një dialog të rregullt me autoritetet lokale, bizneset dhe banorët. Çështjet e mëposhtme tregojnë temat më të diskutuara dhe aktivitetet:

- Bashkëpunimi me komunën e Niklës për të zhvilluar një studim urban të pjesshëm të pjesës së aeroportit që po ndërtohet, i cili do të ndihmojë në zhvillimin e duhur urban të komunës, me aktivitete biznesi të mirëorientuara, mundësi punësimi, si dhe zbatim të rregullave të mjedisit.
- Afrimin e bizneseve të besueshme në Shqipëri për të zhvilluar aktivitetin e tyre në zonën e aeroportit.
- Rikonstrukcionin e shkollave lokale si dhe mundësimin për mbledhjen e mbeturinave të shkollës afër aeroportit nga një nënkontraktor i TIA-s.
- Mbështetje për zhvillimin e zonave turistike dhe muzeale rreth aeroportit.
- Modernizimin e infrastrukturës rrugore.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe me institucionet vendase qeveritare dhe ato shkencore

TIA ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet shtetërore shqiptare, si dhe me institutet shkencore, kërkuese dhe monitoruese të vendit. Ky bashkëpunim përfshin takime, trajnime, bashkëpunim mbi monitorimin e aktivitetit, si dhe diskutime mbi rezultatet e raporteve. Personeli i lartë drejtues i TIA-s është anëtar aktiv i Komiteteve Europiane të ACI (Këshillit Ndërkombëtar të Aeroporteve) mbi çështjet e Ekonomisë, Mjedisit, Sigurisë, dhe Shërbimit të Klientit.



ARRITJET

• *Një grup ekspertësh nga Komisioni European ka vizituar Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës duke vënë në dukje arritjet dhe performancën e aeroportit (raporti i vlerësimit të zonës së fluturimit të përbashkët european-ECAA).*

• *Një analizë mjedisore për programin e planifikuar të zhvillimit, është ndërmarrë nga TIA për të identifikuar pasojat e mundshme dhe masat lehtësuese.*

Analiza mjedisore nuk identifikoi çështje thelbësore që mund të kenë impakt mjedisor dhe social. Përputhshmëria e aktiviteteve të TIA-s me kërkesat mjedisore dhe sociale u rishikua nga departamenti i mjedisit dhe qëndrueshmërisë i EBRD. Rishikimi përfshiu performancën aktuale mjedisore dhe atë të shëndetit e sigurisë, zbatimin e Planit të Veprimit të Mjedisit, Shëndetit dhe Social, të cilin kompania e ka zbatuar në mënyrë të kënaqshme. Në përgjithësi, të gjitha operacionet e TIA-s janë në përputhje me kërkesat aktuale mjedisore, sociale, shëndetësore dhe atyre të sigurisë, si ajo kombëtare, ashtu dhe ajo e Bashkimit European. Një sistem i integruar i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit e sigurisë është në funksion. Mundësitë për përmirësim në fushat e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë janë përfshirë në planin ekzistues të veprimit të mjedisit, shëndetit dhe social.

Referencë <http://www.ebrd.com/projects/psd/psd2005/34052.html>

Fakte dhe shifra

Në vitin 2007, TIA shënoi vitin më të mirë në shifrat e pasagjerëve dhe trafikut të mallrave: i shërbeu 1,107,325 pasagjerëve dhe përpunoi 3,483 tonë mallra (tabela 2). Numri i pasagjerëve u rrit me 22 përqind në krahasim me një vit më parë dhe transporti i mallrave u rrit me 65 përqind. Arritje u shënuan gjithashtu në lëvizjet e trafikut ajror, shifër që shënoi një rritje prej 15 përqind në krahasim me vitin 2006.

Tabela 2 Të dhënat kryesore të TIA-s përfshi këtu ngritjen në përqindje krahasuar me një vit më parë

Të dhëna	2006	2007
Pasagjerët	906,103 (+15%)	1,107,325 (+22%)
Lëvizja e avionëve	15,850 (+2.5%)	18,264 (+15%)
Kargo	2,110 tons (+4.1%)	3,483 tons (+65%)
Xhiro vjetore	EUR 19.5 million	EUR 23.8 million
Personeli i TIA-s	~ 230	~ 270
Personeli i të gjitha kompanive që punojnë në aeroport	~ 900	~ 1000

Figura 2 tregon rritjen progresive të numrit të pasagjerëve, trafikut ajror, si dhe të përpunimit të mallrave dhe bagazheve në vitet 2005-2007.




Figura 2. Ecuria e trafikut për periudhën 2005-2007

Aktualisht 13 kompani fluturimesh operojnë në TIA dhe lidhin direkt kryeqytetin shqiptar Tiranën me 32 destinacione të ndryshme.

Kontakt:

Znj. Alma Bako

Drejtores e Departamentit të Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë

E-Mail: abako@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK

Tirana International Airport Nënë Tereza

Godina e Administratës

Rinas, Tiranë

Shqipëri

Tel: 00355 4 2381 600

Fax: 00355 4 2381 545

info@tirana-airport.com

www.tirana-airport.com